



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1026/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca – Dula, kryetare e kolegjit Gëzim Llulluni dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.G-L nga Prishtina, të cilën e përfaqëson e autorizuar M.G, avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, për pagesën e pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse për në pension, duke vendosur sipas ankesës të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.893/19, të datës 22.10.2019, në seancën jo publike të mbajtur me datë 15.10.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.893/19, të datës 22.10.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.893/19, të datës 22.10.2019, me pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses L.G-L. Me pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Universiteti i Prishtinës që paditëses L.G-L, t’ia kompensojë në emër të tri pagave për shpërblim jubilar dhe tri pagave përcjellëse gjithsej shumë prej 7.700,04 Euro (shtatë mijë e shtatëqind e katër euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën III të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Universiteti i Prishtinës që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 299.00 Euro (dyqind e nëntëdhjetë euro).

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Përgjigje në ankesë nuk është ushtruar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja L.G.-L. nga Prishtina, ka ushtruar padi me datë 26.03.2019, kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, për shkak të kompensimit të pagave jubilarë dhe pagave përcjellëse për në pension, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit të tri pagave jubilarë dhe tri pagave për përcjellje për në pension t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 7.700,04 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.893/19, të datës 22.10.2019, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktgjykimi të atakuar gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratës së punës nr.1907, e datës 25.07.2016, e caktuar në punët dhe detyrat e punës si Përgjegjëse, por kontestuese ishte se paditëses a i takon kompensimi i tri pagave për shpërblim jubilar dhe tri paga për përcjellje për në pension. Gjykata ka shtuar se paditësja me datë 23.10.2016, i ishte drejtuar të paditurës lidhur me pagesën e këtyre pagave, mirëpo e paditura me vendimin e saj nr.6/17, të datës 13.01.2017, e kishte refuzuar kërkesën e paditëses me arsyetimin e se nuk ka bazë ligjore. Tutje gjykata ka shtuar se është vërtetuar fakti se paditësja kishte përvojë pune tek e paditura mbi 30 vite pa ndërprerë dhe të njëjtës nuk i janë paguar pagesat për shpërblimin jubilar dhe tri paga për përcjellje për në pension të parapara me nenin 52 paragrafi 1 nën par.1.1, 1.2, paragrafi 2 dhe 3 si dhe nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Lidhur me lartësinë e pagës mujore në shumë prej 1.283,34 Euro, gjykata e shkallës së parë e kishte vërtetuar në bazë të kontratës së punës nr.1907, e datës 25.07.2016, prej së cilës është vërtetuar se paditësja kishte realizuar pagën mujore në këtë shumë. Tutje gjykata ka shtuar se sa i

përket bazës juridike të kërkesëpadisë e njëjta mbështetet në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive neni 52 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 53, e cila ka hyrë në fuqi në me datë 01.01.2015, dhe e njëjta ka qenë në fuqi në kohën kur paditësja ka dalë në pension me datë 01.10.2016. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm përkitazi me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësja për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension me datë 01.10.2016, dhe se e njëjta ka përvojë pune si mësimdhënëse mbi 30 vite. Përveç kësaj nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagave.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se: Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*. Me nenin 2 të Marrëveshjes së Përgjithshme kolektive përcaktohet se: *“Dispozitat e MPKK, obligojnë palët në Marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje)”*.

Me nenin 52 paragraf 1, të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014, përcaktohet se: ” I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: a) për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; b) për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij dhe c) për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Me paragrafin 2 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, ndërsa në paragrafin 3 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

Me nenin 53 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: ”I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, qe i ka marr për tre (3) muajt të fundit”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit në tërësi të kërkesëpadisë së paditëses, duke e detyruar të paditurën që paditëses t’i paguaj tri paga në emër të shpërblimit jubilar me të drejtë është bazuar në nenin 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e lidhur me datë 18.03.2014, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, ndërsa paditësja ka dalë në pension më datë 01.10.2016, çka do të thotë se kjo marrëveshje ka qenë në fuqi në momentin e pensionimit të paditëses dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës, nga rrjedhë themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar pretendimin e të paditurës se e paditura nuk është nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe ndaj saj nuk mund të lindin detyrime për kompensimin e pagave jubilarë dhe për përcjellje në pension, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret ekziston detyrimi i të paditurës për kompensimin e këtyre pagave, pasi që me dispozitën e nenit 2 pika 1 të kësaj marrëveshje është paraparë se dispozitat e kësaj marrëveshje i obligojnë palët në marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror, çka do të thotë se e njëjta duhet aplikuar edhe për stafin akademik siç janë profesorët universitar dhe meqenëse paditësja është pensionuar me datë 01.10.2016, të njëjtës i njihet e drejta në kompensimin e këtyre pagave.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1026/20, me datë 15.10.2021

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca – Dula, d.v